



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-25892/24 datë:19.09.2024



Npi – 01/312 datë: 27.09.2024

Duke u bazuar në nenet 12.2 shkronja (d) dhe 40.2 shkronja (g) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr. 03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008); Nenin 9 të Ligjit Nr.08/L-224 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr.06/L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme; Propozimin e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa Nr.11/175 të datës 20.09.2024 për miratimin e shkallës tatimore progresive për vitin 2025. Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e mbajtur më 27.09.2024 mori këtë:

V E N D I M

**PËR MIRATIMIN E NORMAVE TATIMORE NË KOMUNËN E SHTIMES
PËR VITIN 2025**

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e -IX- të rregullt për vitin 2024, e mbajtur më 27.09.2024, me shumicën e votave miratoi, Normat tatimore për vitin 2025 në Komunën e Shtimes si vijon:

1	Për vlerën e pronave deri në njëqindmijë (100,000.00) euro aplikohet shkalla tatimore prej	0.10%
2	Për vlerën e pronave mbi njëqindmijë (100,000.00) euro aplikohet shkalla tatimore prej	0.20%
3	Për vlerën e pronave mbi pesëqindmijë (500,000.00) euro aplikohet shkalla tatimore prej	0.30%
4	Për vlerën e pronave mbi njëmilion (1,000,000.00) euro aplikohet shkalla tatimore prej	0.40%
5	Për vlerën e pronave mbi pesëmilion (5,000,000.00) euro aplikohet shkalla tatimore prej	0.50%

II

Kuvendi i Komunës, ka vendosur duke marrë për bazë edhe Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa.

III

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në evidencën e protokolit zyrtar në MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb – faqen zyrtare të Komunës së Shtimes.

IV

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Drejtorive, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe Zyrës për informim.



Kryesuesi e Kuvendit
Adnan Ademi